



ALBANIAN EXCELLENCE

PRESENT

50x50
SIMBOLINJE BREZI

50

50

Simboli i një brezi



ALBANIAN
EXCELLENCE

Titulli:
50 X 50 Simboli i një brezi

Autore:
Flora Nikolla

@ Albanian Excellence

Redaktore:
Anila Struga

Paraqitja grafike:
Elvis Bejtja

Kopertina:
Joni Kraja

ISBN:

Shtypi:

Mbështeti:



LEGJENDA

Flora Nikolla	6
Maya Castro	8
Marsida Koni	10
Natasha Poroçani	12
Vullnet Sinaj	14
Agron Gjikondi.....	20
Alma Sulstarova.....	24
Anissa Markarian.....	30
Antoneta Dhima	36
Arben Cici.....	40
Arben Manaj.....	46
Armand Peza.....	50
Brikela Andrea-Nune	54
Carlo Bollino	60
Daklea Shtylla	66
Dimitra Misrasi	70
Drita Avduli	74
Eda Merepeze.....	80
Edlira Haxhiymeri.....	84
Edmond Isaku.....	88
Entela Gusho	92
Entela Komnino	96
Erenestina Gjergji Halili.....	102
Ester Gjika	106
Etleva Sakajeva	110
Eva Idrizllari	116
Fatos Qerimaj	124
Florian Vlasi.....	128
Flutura Aça.....	132
Gjergj Jozef Kola	136
Helidon Haliti.....	140
Illir Shyta	144
Irena Nikaj	148
Iris Pojani	152
Irma Kurti.....	156
Joe Artid Fejzo.....	160
Joni Kraja	166
Klodeta Dibra	170
Laura Sata Leinonen.....	176
Jeta e Linda Shomo	184
Luan Topçiu	188
Majlinda Keta	196
Margarita Sulaj Skënderi	202
Marta Muço	208
Merita McCormack.....	216
Mimoza Shuli.....	220
Ndrek Gjini	224
Nora Malaj	228
Paçalin Pavaci,	234
Petri Bozo.....	240
Rezearta Reçi.....	244
Rezeart Xhaxhiu	250
Rita Filipi	254
Shëgushe Bebeti	260
Shkëlzen Marku	266
Silvana Sata	274
Sokol Fuga	280
Suzana Varvarica Kuka	286
Teuta Ajdini Haxhillari.....	290
Vasil. S. Tole.....	294
Vjosa Ceka	298
Zajmira Qeraxhiu.....	302



ALBANIAN EXCELLENCE

2 0 1 7

5 Vite Albanian Excellence

100 Histori Suksesi në 100 Vjetorin e Pavarësisë
Berati histori suksesi
Fieri histori suksesi
Vlora histori suksesi
Zonjat shqiptare në Nju Jork
Të vërtetat e një suksesi
50X50 Simboli i një brezi



Ikja e detyruar e Ndrek Gjinit

Web Designer

Ndrek Gjini në vitin 2001 emigroi familjarisht në Irlandë. Vendimin për të ikur e mori pasi u bind se ishte totalisht i paaftë për t'iu përshtatur, sikundër shkruan ai, 'normave të reja' që kishin nisur të formësohen në ndërgjegjen kolektive të shoqërisë shqiptare, ku një maskara quhej i zgjuar, një hajdut quhej i shkathët, një vrasës quhej hero, e një bandit bëhej ministër. Aktualisht, punon si Managing Editor për revistën letrare "The Galëy Review", e cila botohet nga Galëy Academic Press, si dhe është IT Manager për një kompani me Logo Design,

Ndrek Gjini, është freelance lektor në National University of Ireland, Galëy, në programin MA in Editing, ku jep disa orë në seminarët e një lënde që ka të bëjë me shkrimtarinë. Shtëpia botuese Galëy Academic Press, i ka botuar një libër me poezi në anglisht që titullohet "The death of Night".

Punon si përkthyes (freelance) për kompani të ndryshme përkthimesh. Ka shkruar e botuar shkrime dhe disa përkthime në shtypin irlandez dhe atë shqiptar. E ndjen veten me fat pasi disa shkrime, poezi, përkthime dhe intervista, janë botuar në disa gazeta dhe antologji prestigjioze të Irlandës.

EN: *Cili, je realisht? Do të ishte mirë të tregoje, nga je, çfarë bën, por veç këtyre, a mund të tregosh thelbin e vërtetë të qënies tënde...?*

N.Gj: Quhem Ndrej Gjini. Kam lindur në Pukë. Nga viti 1991 e deri më 2001 kam jetuar në Tiranë. Më pas emigrova në Irlandë. Kam shkruar e botuar poezi e publicistikë që në vitin e tretë të shkollës së mesme. Pasi mbarova Universitetin në Shkodër, në degën Gjuhë-Letërsi, punova dy vjet mësues dhe një vit gazetar në gazetën lokale në Pukë. Në vitin 1991 u vendosa në Tiranë. Fillimisht punova në gazetën "Kombi", më pas në Agjencinë "Telegrafike Shqiptare" dhe në gazetën "Rilindja Demokratike". Në vitin 1996, fillova punë si zëdhënës i Ministrisë së Brendshme. Më pas, jam kthyer prapë në gazetën "Rilindja Demokratike". Gjatë gjithë këtyre viteve, përveç punës së përditshme, vazhdoja të shkruaj letërsi duke botuar edhe disa libra. Në vitin 2001 emigrova familjarisht në Irlandë. Vendimin për të ikur e mora pasi u binda se isha totalisht i paafte për t'iu përshtatur 'normave të reja' që kishin nisur të formësohen në ndërgjegjen kolektive të shoqërisë shqiptare, ku një maskara quhej i zgjuar, një hajdut quhej i shkathët, një vrasës quhej hero, e një bandit bëhej ministër. Në Irlandë nuk është se gjeta parajsën. Pata fat përse i përket marrjes së statusit si refugjat politik, pasi e përfitova atë me intervistën e parë. Fillimisht, jeta aty ka qenë një aventurë e vërtetë. Nuk dija asnjë fjalë anglisht. Më duhej të mësoja gjuhën e të punoja për të mbajtur familjen. Jetonim në Castlebar, një qytet mjaft i vogël në perëndim të Irlandës. Nuk kishte as kurse ku mund të shkoje të mësoje gjuhën. Fillova punë si ndihmësfurrtar. Lodhësia shumë. Pas punës, me orë të tëra uleshja e mësoja anglisht në shtëpi. Më ndihmonin shumë gruaje dhe djali. Ia dola mbanë. Kërkova të bëj njohjen dhe konvertimin e diplomës universitare që kisha marrë në Shqipëri. Më thanë nuk bëhet, pasi Shqipëria nuk e kishte firmosur ende marrëveshjen e Bolonjës. Në 2004-n u regjistrova në Castlebar College for Further Education për të bërë një kurs njëvjeçar me kohë të plotë për gazetari të shkruar. E përfundova me sukses. Ndërkohë, përveç punës dhe shkollës, vazhdoja të shkruaj dhe të botoj në gazetën lokale të Castlebar "The Connaught Telegraph". Botova aty mbi 40 artikuj. Në vitin 2005, disa poezi të mia u botuan në një antologji prestigjioze titulluar "Present Tense." Në këtë antologji përfshiheshin autorë mjaft të njohur, njëri ndër to madje, ishte fitues i "Çmimit Nobel". Në vitin 2005, u vendosëm në qytetin Galëy. Aty u regjistrova në shkollë të lartë, në Galëy Mayo Institute of Technology, në programin me kohë të plotë për Bachelor në Heritage Studies (Trashëgimi Kulturor). Studiova për katër vjet dhe u diplomova me BA (Honours) në Heritage Studies (Studime

Trashëgimie). Më pas, vazhdoja programin Master of Arts in Èriting në Universitetin e Irlandës në Galëy. Edhe këtë e përfundova me sukses. Gjatë gjithë këtyre viteve, natën punoja si menaxher në një lokal në stacionin e trenit dhe ditën shkoja në shkollë.

Më pas, kam punuar në Drejtorinë e Kulturës në Bashkinë e qytetit Galëy, si asistent për Artin e Kulturën, si dhe në Drejtorinë Arsimore të këtij qyteti si Advisor, dhe si specialist IT. Aktualisht, punoj si Managing Editor për revistën letrare "The Galëy Review", e cila botohet nga Galëy Academic Press, si dhe jam IT Manager për një kompani që merret me Logo Design. Gjithashtu, jam freelance lektor në National University of Ireland, Galëy, në programin MA in Èriting, ku jap vetëm disa orë në seminare të një lënde që ka të bëjë me shkrimtarinë. Shtëpia botuese Galëy Academic Press botoi libërën tim me poezi në anglisht, që titullohet "The death of Night".

Punoj edhe si përkthyes (freelance) për disa kompani të ndryshme përkthimesh, kam shkruar e botuar shkrime të miat, si dhe disa përkthime në shtypin irlandez dhe atë shqiptar. E ndjej veten me fat pasi disa shkrime, poezi, përkthime dhe intervista të miat janë botuar në disa gazeta dhe antologji prestigjioze të Irlandës.

EN: *E ke menduar ditën e lindjes sipas perceptimit tënd, apo ke mbetur tek tregimi i njerëzve të afërt?*

N.Gj: Jo. Më ka mjaftuar tregimi i nënës time të ndjerë rreth kësaj dite.

EN: *Nëse do të shkruanit çdo gjë që të ka ndodhur deri tani, beson se njerëzit do të donin ta lexonin? Cili do të ishte tharmi që do t'i detyronte ta lexonin?*

N.Gj: As mendja nuk më shkon të shkruaj gjëra të tilla. E konsideroj marrëzi një gjë të tillë, pasi unë nuk kam asgjë të vacantë për të thënë.

EN: *Çfarë quan ti çmenduri? A kujton ndonjëherë prej tyre, e cila pavarësisht etiketimit, ty vazhdon të duket normale?*

N.Gj: Emigrimin tim.

EN: *A ke ndonjë fjalë sekrete që e përdor në momentet e tua të vështira?*

N.Gj: Jo, nuk kam.

EN: *Si do ta përshkruash veten tënde me tre mbiemra?*

N.Gj: Ëndërrimtar, Pasionant, I dedikuar.

EN: *Beson se e njeh veten mirë? Si e njeh?*

N.Gj: Kam besim të plotë se nuk e njoh aspak. Kjo pasi perceptimi im për veten është i ndryshëm nga ai që të tjerët kanë për mua.

EN: *Mund të tregosh historinë më të bukur të jetës në 10 rreshta?*

N.Gj: Ëndërroj dhe shpresoj që nuk më ka ndodhur akoma.

EN: *Po më të vështirën?*

N.Gj: Më tmerron fakti kur ndonjëherë mendoj se mund të jetë ndonjë histori më e rëndë se ajo e natës së parë kur mbërritëm në Irlandë. Isha me gruan dhe dy fëmijët. Na futën të flemë në një dhomë me dy zezakë. Nuk fjeta gjithë natën. Ishte tmerr më i rëndë që kisha përjetuar. Ditën tjetër, e në vazhdim, gjërat ndryshuan për mirë. U stabilizua në një banesë të mirë.

EN: *Ke disa hobby, ti mendon se ke shkuar ti tek ato, apo kanë ardhur ato tek ty?*

N.Gj: Leximi dhe udhëtimet. Besoj se jam unë ai që kam shkuar tek ato.

EN: *Sa herë je ndjerë i tradhtuar? A e fal ti tradhtinë?*

N.Gj: Disa herë. Po, mundohem t'i fal.

EN: *Tani, pas dekadash jetë !!!, pse fëmijët shijojnë fëmijërinë, ashtu si të rriturit shijojnë rritjen?*

N.Gj: Këtë e shkakton mass production dhe teknologjia e informacionit.

EN: *Si mund ta përcaktosh brezin tënd, ke besuar tek ai, cilat kanë qënë kushtet që kanë ndikuar në formimin e tij? A mund të quhet brez i humbur?*

N.Gj: Brezin tim mund ta përcaktoj si Brez i Deformuar. Në formimin e tij ndikoi regjimi paranojak komunist në të cilin jetuam. Unë nuk kam besuar dhe nuk besoj tek ai brez, pasi nuk mund të besoj në diçka të deformuar.

EN: *Cfarë nuk duron tek të tjerët dhe si e kapërcen mosdurimin ...?*

N.Gj: Hipokrizinë. E kapërcëj duke bërë sikur nuk e kam kuptuar atë çfarë ata kanë kurditur.

EN: *Mes njeriut më tërheqës, por edhe më të varfër, njeriut më të pasur, por edhe më të shëmtuar, cilin do të zgjidhje?*

N.Gj: Atë më të varfër

EN: *Cilat janë tre cilësitë që çmon tek një njeri?*

N.Gj: Sinqeritetin, inteligjencën dhe përkushtimin.

EN: *Si dhe cfarë është për ty shtëpia jote? Cili është objekti më i çuditshëm që keni në dhomën tuaj?*

N.Gj: Shtëpia është gjithçka. Ajo ndryshon nga banesa. Unë kam një banesë ku jetoj dhe një shtëpi që e kam braktisur. Në banesë gjënë më të çmuar kam librat. Në shtëpinë e braktisur kam kujtimet.

EN: *Cfarë vendi zë gënjeshtria në jetën tënde? Në fakt kur gënjen?*

N.Gj: Vend fare të parëndësishëm. E përdor vetëm kur e di që e vërteta mund të vrasë në shpirt shumë rëndë ndokënd.

EN: *Cili je ti në bashkëbisedim me një mik?*

N.Gj: Jam një fëmijë i sinqertë që nuk i pushon kurrë goja.

EN: *Cfarë është frika për ty? Cilat janë frikërat më të*

mëdha që ke dhe si i kontrollon? Cfarë të frikëson ty në këtë botë?

N.Gj: Unë jam shumë frikacak. Frika më e madhe është vdekja. Mundohem ta kontrolloj atë duke punuar parreshtur për të lënë kujtime të mira tek ata që do të jetojnë pas meje dhe që më kanë njohur.

EN: *Si do ta komentoni: "Sa më shumë kalojnë vitet, aq më inteligjentë më duken prindërit?"*

N.Gj: Përgjigjen më të bukur e jep Mark Tëain kur thotë: "Kur isha 14 vjeç, babai im ishte aq injorant sa që nuk e hopenja dot ta kisha afër meje atë plak maruf. Por kur u bëra 21 vjeç, isha shumë i surprizuar se sa shumë kishte mësuar dhe sa inteligjent ishte bërë im atë në këto shtatë vjet".

EN: *Cila është fuqia që ju keni? Në fakt cfarë fuqie do të donit të kisht?*

N.Gj: Fuqia ime është pasioni me të cilin unë i bëj punët. Kjo fuqi më mjafton.

EN: *Nëse do të merrje vesh se do të vdisje brenda një viti, si do ta organizoje jetën tënde?*

N.Gj: Do të udhëtoja çdo ditë duke vizituar vende të ndryshme deri në ditën kur vdekja do të trokiste në portën time.

EN: *Pse ke zgjedhur modele, apo personazhe në jetën tënde, cfarë të ka shtyrë? Nëse do të darkojë me të për cfarë do ta pyesje dhe si do të ishte sjellja juaj?*

N.Gj: Nuk besoj në modele. Modeli më i mirë është vetja ime të cilin mundohem ta përsos çdo minutë.

EN: *Keni një proverb tuajin të preferuar, për cfarë ju shërben?*

N.Gj: Janë disa. I përdor sipas rastit.

EN: *Thonë që kur të pëlqen puna që bën, çdo ditë ngjan si të ishte pushim... është e vërtetë? Si dhe ku i organizon pushimet e tua ideale?*

N.Gj: Jo nuk është e vërtetë. Puna, sado që ta dashurosh at, prapë të lodh. Organizimi i pushimeve nuk varet vetëm nga dëshirat e mia, pasi unë jam familjar. Janë grua dhe fëmijët që vendosin.

EN: *Cilat janë marrëdhëniet e tua me blerjet? Po nëse do të mund të blije vetëm një gjë, cfarë do të zgjidhje të blije?*

N.Gj: Shumë të zbehta. Blerjet nuk janë pasioni im. Nëse do të kisha mundësi do të bleja një shtëpi diku në mal, me një bibliotekë të madhe.

EN: *Po raportet tuaja me gjërat e reja... Nëse do të mund të mësonit diçka të re, cilën do të zgjidhni?*

N.Gj: Raporte shumë të ngrohta dhe pasionante. Mundohem të mësoj çdo ditë diçka të re. Nga mosha 44 deri 50 vjeç kam studiuar me kohë të plotë në Universitetin në Irlandë dhe fitova BA Honours ne Heritage Studies dhe më pas MA in Writing. 51 vjeç mësova computer koding dhe eëhsite design. Ndoshta kur të jem 60 vjeç do filloj të mësoj gjuhën kineze.

- EN:** *Ndër të tjera libri është një tru që flet, një mik që pret, një shpirt që fal, një zemër që qan... Çfarë lidhje ke me librat dhe cili është vendi që kanë zënë në jetën tënde.*
- N.Gj:** Lidhje dashurie. Dhe si rezultat, vendi që ato zënë në jetën time është ai i një dashurie pasionante që do të vdesë vetëm kur të vdes unë.
- EN:** *Mund të gjykojmë një njeri nga mënyra se si i trajton kafshët? Cila është lidhja që ke me kafshët?*
- N.Gj:** Jo, mendoj se nuk mund ta gjykojmë kurrësi. Unë nuk kam ndonjë lidhje të ngushtë me kafshët. E si mund të kem kur mendoj se disa prej tyre ne i hamë.
- EN:** *Po raporti që ke me trupin tënd... Cila është pjesa e trupit që të pëlqen më shumë dhe pse?*
- N.Gj:** Me gojën nuk i kam raportet e mira pasi flas shumë. Pjesa që më pëlqen më shumë është koka. Kjo, pasi ma ka mbajtur akoma trurin në vend.
- EN:** *Bota është një libër, dhe ata që nuk udhetojnë lexojnë vetëm një faqe. Cili është raporti që keni me udhëtimin?*
- N.Gj:** Udhëtimin nuk do e ndërroja me asgjë në këtë jetë.
- EN:** *Në cilin vend të botës do të pëlqente të jetoje?*
- N.Gj:** Nuk e di. Jam akoma në kërkim të këtij vendi magjik. Ndoshta qyteti i Pukës mund të jetë destinacioni im pas disa vitesh.
- EN:** *Liria ... cila është përballja juaj me të, si ka qënë raporti me lirinë në jetë, sa e keni luftuar dhe sa e keni dashur?*
- N.Gj:** Unë mendoj se ajo ekziston vetëm si iluzion. Të gjithë luftojmë për t'i zgjeruar kufijtë e saj. Nuk e di sa ia kemi arritur. Unë për vete kam dështuar.
- EN:** *Cili është ndryshimi që ke mes bashkëshortes dhe të dashurës? Mendon se ekziston dashuria e përjetshme? Si mund të shpëtohet dashuria?*
- N.Gj:** Këtu janë tre pyetje në një. Së pari, në rastin tim ka qëlluar që bashkëshortja dhe e dashura të jenë një. Së dyti, nuk e di nëse dashuria e përjetshme ekziston apo jo, pasi ky proces tek unë nuk ka mbaruar ende. Dhe së treti mund të them prapë se, nuk e di se si mund të shpëtohet dashuria.
- EN:** *Çfarë është vlerësimi shoqëror dhe familjar për ty? Deri kur do të vazhdojë të ketë vlerë?*
- N.Gj:** Vlerësimi shoqëror sipas mendimit tim është një kod dogmash të shkruara dhe të pashkruara. Nuk e di se sa do të zgjasë ky absurd.
- EN:** *Kur një person hedh argumente kundër ideve tua, preferon të mbetesh i heshtur duke ditur se ke të drejtë, apo mendon se është më mirë të tregosh "të vërtetën"?*
- N.Gj:** Zakonisht nuk qëndroj i heshtur, por debatoj duke sjelle argumentet e mia.
- EN:** *Thuhet se asgjë nuk është perfekte... Çdo ndodhte sikur të ishte?*
- N.Gj:** Sikur të ndodhte kjo, bota do ngjante si një varrezë e përkryer mermeri.
- EN:** *Në të mirë dhe në të keq, një mik i vërtetë, është gjëja më e mirë në këtë botë. Çfarë është një mik-mikeshë për ju?*
- N.Gj:** Ai është gjithçka. Është 'unë' në trupin dhe mendjen e një tjetri.
- EN:** *Cila ka qënë detyra më e mërziqshme që të ka takuar të bësh?*
- N.Gj:** Ndihmësfurrtar.
- EN:** *Në punën tuaj më të fundit, cilat qenë arritjet më të rëndësishme?*
- N.Gj:** Freelance Lektor në Universitet.
- EN:** *Çfarë projektesh apo ide kanë lindur nga ty dhe sa janë realizuar falë teje?*
- N.Gj:** Kanë lindur me qindra. Janë realizuar më pak se dhjetë. Jam një dështak i paepur.
- EN:** *Tranzicioni shqiptar është përballje e vlerave të shoqërisë shqiptare apo e politikës së prodhuar nga qeveritë e saj?*
- N.Gj:** E t'j dyjave bashkë!
- EN:** *Jeta jote përballë politikës... cili është vlerësimi yt për politikën shqiptare?*
- N.Gj:** Nuk mund t'i përgjigjem kësaj pyetje, pasi nuk jam i bindur nëse kjo mund të quhet politikë apo banditizëm.
- EN:** *Çfarë është Shqipëria për ty?*
- N.Gj:** ADN-ja ime.
- EN:** *Sa është përputhur profesioni që ke imagjinuar në fëmijëri me profesionin që ke sot?*
- N.Gj:** Nuk ka asnjë përputhje.
- EN:** *Sa i lumtur je sot dhe si e përjeton profesionin tënd?*
- N.Gj:** Sipas mendimit tim lumturia e vërtetë nuk arrihet, nuk preket. Është një ëndërr e bukur që në momentin që e prek, vdes.
- EN:** *Do të preferonit të udhëtonit në të shkuarën apo në të ardhmen e vendit ku jetoni?*
- N.Gj:** As në të shkuarën e as në të ardhmen. Më del dhe tepron e tashmja e tij.
- EN:** *Për ty çfarë do të thotë një jetë perfekte?*
- N.Gj:** Ajo nuk ekziston. Të paktën ky është mendimi im.
- EN:** *Sa i e vërtetë, keni qënë në këtë intervistë?*
- N.Gj:** Aq sa më lejon ADN-ja ime.